



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:127021

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06598218

K.Dh.SH.II.nr.1429/24

GJYKATA KOMERCIAL E KOSOVËS E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi në çështjen përmbartimore të kreditorit "RAFII" SH.P.K., me NUI: 810393083, me seli në rr. "Xhelal Hajda Toni", p.nr., në Rahovec, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bajram Morina, avokat nga Gjakova, kundër debitorit "NTP Citadela" O.P., me NUI: 811640037, me seli në rr. "Ali Kelmendi", nr.1, në Klinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Albana Kelmendi, avokate nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.745/24 të datës 31.05.2024, me datën 12.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit "NTP Citadela" O.P., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.745/24 të datës 31.05.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.745/24 të datës 31.05.2024, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit "NTP Citadela" O.P., dhe ka anuluar pjesërisht Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.200/2024 i datës 05.04.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, sa i përket kamatës ligjore prej 8 %, të kërkuar në emër të detyrimit kryesor nga data 21.07.2021 e deri në përmbushjen definitive si dhe për pjesën e kamatës në lartësi prej 8%, të kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit "NTP Citadela" O.P., duke lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.200/2024 të datës 05.04.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha. Në pikën III të dispozitivit ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbartimore e kreditorit "RAFII" SH.P.K.,

ndaj debitorit “NTP Citadela” O.P., sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.200/2024 të datës 05.04.2024, sa i përket kamatës ligjore prej 8 %, të kërkuar në emër të detyrimit kryesor nga data 21.07.2021 e deri në përmbushjen definitive, si dhe për pjesën e kamatës në lartësi prej 8%, të kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit “RAFII” SH.P.K., me seli në Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, II.EK.nr.38/18 të datës 14.02.2019, të ndryshuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr 137/19 të datës 07.06.2021.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor duke theksuar ndër të tjerash se ky urdhër është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore, ngase dokumenti në bazë të së cilit është marr urdhri përmbarues nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se propozimi për përmbarim bazohet në Aktgjykimin si titull ekzekutiv, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 07.06.2021 dhe i ekzekutueshëm me datën 20.07.2021, i cili është dorëzuar së bashku me shënimin zyrtar lidhur me plotfuqishmërinë e Gjykatës Komerciale të Kosovës në Prishtinë të datës 22.02.2024

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.745/24 të datës 31.05.2024 , duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet sa i përket kamatës ligjore prej 8 %, të kërkuar në emër të detyrimit kryesor nga data 21.07.2021 e deri në përmbushjen definitive si dhe për pjesën e kamatës në lartësi prej 8% të kërkuar në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore për faktin se e njëjta nuk është në përputhje me dokumentin përmbarimor. Sipas

dokumentit përbarues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, Ae.nr 137/19, të datës 07.06.2021 debitori "NTP Citadela" është detyruar që kreditorit "Rafi" SH.P.K., të t'ia paguaj në emër të borxhit, shumën prej 25,500.00 €, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat e Kosovës, për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 17.03.2011 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 2,767.00 €, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përbarimit me detyrim.

Gjykata Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimi e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përbarimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përbarues në bazë të cilit është lejuar përbarimi është - Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike II.EK.nr. 38/18 i datës 14.02.2019, i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, Ae.nr 137/19, të datës 07.06.2021 është i plotfuqishëm nga data 07.06.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 20.07.2021 dhe se i njëjti është dorëzuar në kopje të vërtetuar nga noteri, i cili në rastin konkret është dokument përbarues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: "*dokument përbarimor është vendimi përbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përbaruese*" dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: "*dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*", andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje dhe interpretim të gabuar të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Gjykata mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase aktgjykimi është bërë i formës së prerë dhe të ekzekutueshëm, andaj i plotëson kushtet për caktimin e përbarimit në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Nuk janë pranuar as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata përbarimore me saktësi ka konstatuar rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi përfshirë edhe kushtet formale nga të cilat varet lejueshmëria e përbarimit.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS NË PRISHTINË,
Dhomat e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr1429/24 me datën 12.12.2024

Gj y q t a r i,
Ramush Bardiqi